



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 102 Akti

Nr. 204 Vendimi
Tiranë, më 6.11.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në datën 6 nëntor 2019, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Joana Qelesi**, me funksion gjyqtare/kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

BAZA LIGJORE: **Neni G, i Aneksit të Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Germa “a”, e pikës 1, të nenit 64, dhe neni 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleđa Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. ***, datë 24.10.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shkresat e dërguara me anë të postës elektronike datë 29.10.2019, për arsyet e dorëheqjes nga subjekti i rivlerësimit, znj. Joana Qelesi, e cila ka kërkuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Joana Qelesi, gjatë periudhës së procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e gjyqtarës/kryetarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Në bazë të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Joana Qelesi, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar më datë 15.3.2018, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Genta Tafa (Bungo), Pamela Qirko dhe Etleđa Çiftja.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 26.3.2018, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit; si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisionere Genta Tafa (Bungo). Të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit.
5. Komisioni, me anë të postës elektronike¹, njoftoi subjektin e rivlerësimit se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procesin e rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës si dhe të ligjit nr. 84/2016, “ Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
6. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, të shortuar në datën 15.3.2018 dhe iu kërkua të deklaronte nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues².

¹ E-mail, datë 27.3.2018, ora 15:27.

² E-mail, datë 7.6.2018, ora 14:53.

7. Në përgjigje të *e-mail*-it, të dërguar sipas pikës 6 më lart, subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike³ deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
8. Pasi relatori i çështjes kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, paraqiti para trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, rezultatet e hetimit dhe rekomandoi mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Joana Qeleshi.
9. Në mbledhjen e datës 14.10.2019, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi arriti në përfundimin se provat në lidhje me kriterin e pasurisë dhe kontrollit të figurës kanë nivelin e provueshmërisë, me vendimin nr. 2, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Joana Qeleshi, dhe të njoftojë subjektin se ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, sipas përcaktimeve të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës.
10. Me anë të postës elektronike⁴ subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi mbylljen e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës për kriterin e pasurisë dhe për kontrollin e figurës. Subjektit iu bënë me dije të drejtat që gëzon sipas ligjit për: (i) njohjen me dokumentet e dosjes dhe marrjen kopje të tyre menjëherë pas marrjes së njoftimit; (ii) të drejtën për të thirrur dëshmitar apo marrjen e çdo prove mbështetëse; (iii) të drejtën për të paraqitur shpjegime apo prova me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, jo më vonë se data 29 tetor 2019. Bashkëlidhur këtij *e-mail*-i, subjektit të rivlerësimit iu dërguan: (i) rezultatet e hetimit kryesisht në versionin *word* dhe *pdf*; (ii) analiza financiare në *pdf* dhe *excel*; (iii) dhe metodika e përdorur në analizën financiare.
11. Në datë 18.10.2019, ora 14:00, subjekti, pas marrjes së dokumentacionit përbërës të dosjes, deklaroi se: (i) u njoh dhe mori të gjithë dokumentacionin e kërkuar në *CD* dhe/apo në formë shkresore (fotokopje) sipas kërkesës së saj; (ii) nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin e tërhequr në Komision; dhe (iii) ky dokumentacion është konform me dokumentacionin e dosjeve që i është vënë në dispozicion sipas inventarit përkatës bashkëlidhur kësaj deklaratë
12. Më datë 24.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. *** prot., njoftoi Komisionin se në seancën plenare të datës 24.10.2019 ka vendosur të miratojë kërkesën për dorëheqje të znj. Joana Qeleshi, duke deklaruar mbarimin e statusit të subjekti të rivlerësimit si magjistrate pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Bashkëlidhur kësaj shkrese KLGJ-ja ka dërguar kopjen e vendimit nr. ***, datë 24.10.2019 .
13. Me vendimin nr. ***, datë 24.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: (i) deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. Joana Qeleshi, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status; (ii) efektet e këtij urdhërimi fillojnë në datën 31.10.2019; dhe (iii) të njoftohet për këtë vendim znj. Joana Qeleshi, bazuar në nenin 61, të ligjit nr. 115/2016 dhe në pikën 3, të nenit 65, të ligjit nr. 84/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas shqyrtimit të kërkesës për heqje dorë nga statusi i magjistratit mbi motivin “*e angazhimit në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor*”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

³ E-mail, datë 8.6.2018, ora 12:13.

⁴ E-mail, datë 14.10.2019, ora 15:19, “Komisioni – Njoftim mbi mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

14. Më datë 29.10.2019, në përgjigje të e-mail-it të datës 14 tetor 2019 mbi njoftimin e rezultateve të hetimit kryesisht, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike⁵ paraqiti sqarimet dhe kundërshtimet e saj në lidhje me gjetjet e parashtruara në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht të Komisionit dhe referuar vendimit nr. ***, datë 24.10.2019, të KLGJ-së, kërkoi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, bazuar në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 65/3 të ligjit nr. 96/2016.

15. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime të plota në lidhje me vullnetin e shprehur me aktin e dorëheqjes nga statusi i magjistratit, referuar nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, Komisioni vlerëson se nuk është e nevojshme të ftohet subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore publike.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

16. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Joana Qeleshi, ka filluar në respektim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

17. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara për sa më lart, konstaton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit është me detyrë gjyqtare/kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
- ii. Procesi i rivlerësimit ndaj saj nuk ka përfunduar me vendim sipas pikës 1, të nenit 58, dhe me një nga masat disiplinore respektive sipas nenit 59 “*Konfirmimi në detyrë*”, të nenit 60, “*Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit*”, dhe të nenit 61, “*Shkarkimi nga detyra*”;
- iii. Sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës subjekti i rivlerësimit, znj. Joana Qeleshi, ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen;
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit me vendimin nr. *** datë 24.10.2019 ka vendosur deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit Joana Qeleshi, për shkak të dorëheqjes së motivuar nga ky status.

18. Në këto kushte, referuar fakteve të konstatuara më lart, Komisioni çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin, znj. Joana Qeleshi, duhet të ndërpritet sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

Për pasojë, subjekti i rivlerësimit znj. Joana Qeleshi humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

19. Sipas nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, përcaktohet: “1. *Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.* 2. *Subjekti i*

⁵ Email datë 29.10.2019, ora 7:24 pm

rivlerësimi që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.”

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Joana Qelesi, me funksion kryetare/gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Joana Qelesi si gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall, në datën 6.11.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (Bungo)
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj